



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 500 Dt. 06.09.2022

PRISHTINË • PRISTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Biloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Prishtinë, 6 shtator 2022

Bazuar në Rregulloren mbi Punën e Komisionit Arbitrar të Federatës së Basketbollit ("FBK"), të datës 19.02.2017, dhe Rregulloren për Regjistrim dhe Kalim në FBK të datës 28.07.2022, si dhe në bazë të Ankesës së KB Peja të datës 19.08.2022, Komisioni Arbitrar i FBK-së, me datë 06.09.2022 merr këtë:

V E N D I M

- I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa e KB Peja e datës 19.08.2022.
- II. REFUZOHET Ankesa e KB Peja e datës 19.08.2022 si e pabazuar.
- III. VËRTETOHET në tërësi Vendimi Nr. 1/2022 i datës 17.08.2022 i Komisionit të Garave të FBK-së, me numër protokoli 474.

A R S Y E T I M

Më datë 20.08.2022, Komisioni Arbitrar i FBK-së ("KA"), përmes postës elektronike, nga sekretarja e FBK, ka pranuar Ankesën e KB Peja të datës 19.08.2022 (tash e tutje "Ankesa"), e parashtruar kundër Vendimit Nr. 1/2022 i datës 17.08.2022 të Komisionit të Garave të FBK-së ("KG-FBK"), me numër protokoli 474 (tash e tutje "Vendimi"), lidhur me transferimin e lojtarit Daniel Lekndreaj nga KB Peja tek një klub tjetër. Përmes Vendimit në fjalë, ndër të tjera, KG-FBK kishte konstatuar se Daniel Lekndreaj "mund të licençohet si lojtar ri lirë për edicionin 2022-23 . . ."

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Në këtë kuadër, KA ka mbajtur takime më 22.08.2022, 24.08.2022, 26.08.2022 dhe 02.09.2022. Takimi i datës 26.08.2022 ka qenë seancë dëgjimore, në të cilën prezente kanë qenë përfaqësuesi i KB Peja, si dhe Daniel Lekndreaj bashkërisht me përfaqësuesin e tij të autorizuar, z. Armend Kelmendi.

Në fakt, vlen të përmendet edhe fakti se KA, në kuadër të seancës dëgjimore së mbajtur më datën 26.08.2022, iu ka dhënë mundësi edhe njëherë palëve që të zgjidhin mosmarrëveshjen me një marrëveshje në mes tyre përmes negociatave. Si afat për arritje të marrëveshjes është caktuar dita e premte, datë 30.08.2022. Fatkeqësisht, edhe pas kalimit të këtij afati, nuk është arritur një marrëveshje në mes të palëve.

Që nga fillimi i rastit, të dyja palët kanë prezantuar prova, përmes të cilave kanë mbështetur pretendimet e tyre lidhur me rastin.

KA ka trajtuar Ankesën e KB Peja, si dhe provat e tjera që janë pjesë e dosjes së lëndës.

Sipas kuptimit të Komisionit Arbitrar, KB Peja në Ankesë sfidon Vendimin e KG-FBK, duke 1) theksuar se KG-FBK nuk ka pasur kompetencë që të shqyrtojë rastin, pasi që në aspekt kontraktual, palët kanë përzgjedhur Basketball Arbitral Tribunal në Gjenevë si tribunal për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kontraktuale në mes të palëve; dhe 2) kundërshtuar konstatimin e KG-FBK se Daniel Lekndreaj është lojtar i lirë, si në kundërshtim me kontratën ekzistuese në mes të palëve.

Komisioni i Arbitrazhit gjatë trajtimit të lëndës ka shqyrtuar të gjitha dokumente përkatëse dhe provat në dispozicion, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsytet në vijim.

1) Kompetenca e KG-FBK dhe KA për të shqyrtuar rastin

Në Ankesë, KB Peja ka kontestuar mandatin e KG-FBK për të shqyrtuar kontestin në mes të KB Peja dhe lojtarit Daniel Lekndreaj, duke u thirrë në Nenin 18 të Kontratës së Punës të datës 6 korrik 2021 në mes të KB Peja dhe lojtarit Daniel Lekndreaj ("Kontrata"), që përcakton Basketball Arbitral Tribunal në Gjenevë si tribunal për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kontraktuale në mes të palëve. Mirëpo, në seancën dëgjimore të datës 26.08.2022, KA ka pyetur përfaqësuesin e KB Peja nëse kontestojnë kompetencën e KA për të shqyrtuar këtë rast, respektivisht edhe ankesën e KB Peja. Përfaqësuesi i KB Peja ka theksuar në atë seancë se me vet paraqitjen e ankesës, KB Peja është pajtuar me kompetencën e KA për të shqyrtuar rastin, dhe rrjedhimisht kjo pikë e ankesës është tash më jolëndore.

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Edhe sikur KB Peja të mos hiqte dorë nga ky pretendim, KA pavarësisht do të ishte kompetent për të shqyrtuar këtë rast, pasi që kompetenca e KG-FBK dhe KA për të shqyrtuar çështje që ndërlidhen me ndërprerjen (shkëputjen) e marrëveshjeve buron nga Nenet 20 dhe 36 të Rregullores për Regjistrim dhe Kalim në FBK të datës 28.07.2022, dhe palët nuk mund të kontraktjnë në kundërshtim me këto dispozita të Rregullores.

Rrjedhimisht, KA ka kompetencë që të shqyrtojë ankesën e KB Peja, për arsyet e cekura më sipër.

2) *Meritat e Ankesës*

Është fakt i pakontestuar se palët kanë nënshkruar Kontratën në mes tyre më datë 6 korrik 2021. Mirëpo, të dyja palët bazohen në Nenin 12 të kësaj Kontrate, duke i dhënë interpretime kundërtë. Nëse.

Leximi i Kontratës në fjalë nga KA është i tillë që len të kuptohet se Kontrata fillimisht është nënshkruar për sezonin dimëror të vitit 2021, në vlerën totale prej 9.000,00 EURO si kompensim për lojtarin Daniel Lekndreaj. Neni 12, ndër të tjera thotë se "Klubi ka opcionin që të zgjedh për përtrirje të kontratës edhe për një sezonë në 2022 ..."

Bazuar në Nenin 12, shihet se KB Peja veq ka përtrirë kontratën me lojtarin për sezonin pranveror/veror 2022 (dmth janar 2022 deri maj 2022). Pra, e ka përtrirë kontratën për edhe një sezonë në 2022, ashtu si e parasheh Neni 12 i Kontratës. Kjo mund të konstatohet nga fakti se KB Peja ka kompensuar lojtarin Daniel Lekndreaj nga 13.09.2021 e deri në korrik 2022, shumat që arrijnë vlerën prej 19,000.00 EURO, prej të cilave 17,000.00 EURO janë transferuar përmes xhirollogarisë bankare dhe 2,000.00 EURO i janë dhënë para të gatshme lojtarit Daniel Lekndreaj.¹ Fakti se KB Peja ka paguar më shumë se vlerën fillestare të Kontratës, pra vlerën prej 9,000.00 EURO, është provë e fuqishme se Kontrata është përtrirë edhe për një sezonë, për atë pranveror 2022.

¹ Pretendimi në seancë nga Daniel Lekndreaj se nuk ka pranuar pagesën prej 2,000.00 EURO në para të gatshme është i pabesueshëm për KA sepse ato mjete nuk janë pretenduar asnjëherë nga lojtari Daniel Lekndreaj në këmbimet shkresore me KB Peja, dhe nuk janë listuar si bazë për shkëputjen e Kontratës në shkresat e dorëzuara nga ai tek KB Peja. Në fakt, edhe provat e tjera rrethore të prezantuara nga të dyja palët mbështesin faktin se pagesa prej 2,000.00 me para të gatshme i është bërë lojtarit Daniel Lekndreaj nga KB Peja.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Prandaj, me këtë përritje, edhe është ezauruar diskrecioni për përritje unilaterale të Kontratës nga KB Peja, dhe me përfundim të sezonës pranverore 2022, edhe obligimet kontraktuale të ndërsjella në mes të palëve kanë përfunduar, dhe lojtari Daniel Lekndreaj konsiderohet të jetë lojtar i lirë, ashtu si ka konstatuar edhe KG-FBK.

Lidhur me pretendimin e KB Peja se Neni 12 ka kuptimin e përritjes së kontratës për edhe një vit, KA vëren se ka disa mangësi në këtë argumentim. Fillimisht, nëse përritja është bërë më 22 korrik 2022, ashtu si edhe pretendon KB Peja përmes komunikimit elektronik, atëherë, me çfarë baze juridike ka luajtur lojtari Daniel Lekndreaj në periudhën janar-maj 2022. Pra, nëse Neni 12 flet për edicionin 2022-2023, atëherë në bazë të çfarë kontrate ka paguar KB Peja lojtarin Daniel Lekndreaj në periudhën janar 2022 dhe maj 2022 (vlera prej 10,000.00 EURO mbi vlerën e Kontratës), pasi që në Nenin 3, Kontrata flet vetëm për pagesa deri më 31 dhjetor 2021, dhe ka mungesë të një verifikimi shkresor të përritjes.

Dhe nëse ka pasur përritje verbale për periudhën janar-maj 2022, dhe janë paguar katër paga nga 2,500.00 EURO, ashtu si edhe i ka evidentuar KB Peja, atëherë, pse nuk është paguar bonusi për vazhdimin e kontratës prej 1,500.00 EURO (sign-on bonus), që i takon lojtarit në rastin e përritjes së Kontratës, sipas Neni 12 të Kontratës, dhe të cilin në vazhdimësi e ka pretenduar dhe kërkuar lojtari Daniel Lekndreaj nga KB Peja. Qëndrimi i KB Peja se "sign-on bonus" jepet vetëm në rast të nënshkrimit të Kontratës është qëndrim paarsyeshmërisht i ngushtë i kuptimit të fjalës, veçanërisht pasi që ka pranuar benefitet e Kontratës pa e vazhduar atë me shkrim, dhe KA konstaton se "sign-on bonus" është dashur të jetë pjesë e paketës së kompenzimit për lojtarin në fjalë, të cilin kompenzim KB Peja edhe në seancën dëgjimore konfirmoi se nuk e ka paguar.

Pasi që kjo qëndron, edhe sikur qëndrimi i KB Peja se përritja e kontratës nga KB Peja është valide, atëherë, dështimi i KB Peja për të kompenzuar lojtarin Daniel Lekndreaj me kompenzimin e plotë, i ka dhënë atij të drejtën që të shkëpusë Kontratën në përputhje me Nenin 3 të Kontratës, natyrisht pas dhënies së paralajmërimeve të parapara në këtë nen. KA ka vënë re se lojtari Daniel Lekndreaj ka paralajmëruar KB Peja se ajo i detyrohet edhe 4,000.00 EURO, dhe si rezultat i mospagesës të të njëjtave, më 12 gusht 2022, i dërgon komunikim elektronik KB Peja, përmes të cilit e shkëputë

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Kontratën.² Dhe nuk mund të mohohet nga KB Peja e drejta e lojtarit për të komunikuar me klubin përmes mjeteve elektronike, pasi që edhe vet klubi ka pretenduar përtrirjen e Kontratës përmes komunikimit elektronik të datës 22 korrik 2022 dhe komunikimi elektronik ka qenë mënyrë e rregullt e komunikimit të ndërsjellë.

Shto kësaj edhe pretendimin e lojtarit Daniel Lekndreaj për pageën numër pesë në vlerë prej 2,500.00 EURO, për periudhën janar-maj 2022. Është fakt i ditur botërisht se sezona pranverore e FBK ka zgjatur nga mesi i muajit janar deri në mes të muajit maj 2022, dhe për KA është e pakuptimtë që kompenzimi i lojtarit të mos bëhet fare për angazhimin që e bën në janar para fillimit të sezonës pranverore 2022 (përgatitjet para fillimit të sezonës), veçanërisht kur në sezonën paraprake në bazë të Nenit 3 të Kontratës, përveq "sign on bonus", kanë qenë të parapara edhe pesë paga shtesë. E njëjta mund të kuptohet me analogji se do duhej aplikuar edhe në sezonën pranverore 2022, dhe provat tregojnë vetëm për katër paga të paguara nga 2,500.00 EURO, me vlerë totale 10,000.00 EURO. Mungesa e pagesës së pagës së pestë, ka qenë edhe pretendimi shtesë i lojtarit Daniel Lekndreaj për shkëputjen e Kontratës, përpos mospagesës së sign-on bonus prej 1,500.00 EURO, dhe që KA e gjenë si të bazuar.

Nga kjo që u tha, KA edhe erdhi deri tek përfundimi se lojtari Daniel Lekndreaj konsiderohet lojtar i lirë pasi që Kontrata është përtrirë nga KB Peja për sezonin pranveror 2022, me që rast ka ezauruar opcionin për përtrirje unilaterale për edhe një sezonë. E edhe nëse përtrirja është për një vit të plotë, ashtu si u cek më sipër, mopërmeshja e plotë e detyrimeve nga KB Peja ndaj lojtarit Daniel Lekndreaj i ka dhënë atij të drejtën e shkëputjes së Kontratës, me që rast ai e ka bërë atë në përputhje me procedurat e parapara me Kontratë.

² Lidhur me pretendimin e KB Peja për falsifikim të komunikimit elektronik të datës 12 gusht 2022, përmes të cilit lojtari Daniel Lekndreaj njofton KB Peja për shkëputjen e Kontratës, KA konsideron se nuk është organ i ndjekjes penale, prandaj, nuk ka kompetencë që të vlerësojë autenticitetin e dokumenteve të prezantuara si prova dhe ua jep atyre besimin e plotë deri në atë moment kur një organ përgjegjës i ndjekjes penale e vërteton të kundërtën.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Biloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Rrjedhimisht, KA duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Arbitrar:

Fidan Hamiti
Anëtar

Korab R. Sejdiu
Kryetar

Lulzim Fushtica
Anëtar



Prishtinë, 6 shtator 2022

Vendimi i dërgohet:

- KB Peja
- Deaniel Lekndreaj
- Anëtarëve të Komisionit Arbitrar
- Arkivit të FBK-së

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball supporters:

